

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Diaspora është me ne"/ Berisha: Rama është e shkuara, PD duhet të bëjë gjithçka për ripërtëritjen e saj
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/diaspora-eshte-me-ne-berisha-rama-eshte-e-shkuara-pd-duhet-te-beje--i515006
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 13:03:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a90904f24285630df400194749ca52f3c01400ef83f9461d2768c7c0f9af44d
TEKSTI	1a9ea69cff004f88989fcb0a23557b1e206c1e133cab1332f8ed5a6285df78e
PAMJA	252a8a721605eb3e5d709cd5c4a5680d2680b93be72751dbdca0842c22631593

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	150fe66cd3a10202ef1b1354007529af1a0e6d24dd10fd527f1f5e084ee7778b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aea7d85c4e1ffedb330a4f0c595bceb62319ead8019dd1bf570799cb9f2d4d85
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/150fe66cd3a10202ef1b1354007529af1a0e6d24dd10fd527f1f5e084ee7778b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

2 MINUTA ME PARE

"Diaspora është me ne"/ Berisha: Rama është e shkuara, PD duhet të bëjë gjithçka për ripërtëritjen e saj

2 ORE ME PARE

Krim në familje/ I moshuari godet me thikë gruan, humb jetën në spital. Shoqërohet dhëndëri i tyre në Polici

19 ORE ME PARE

111 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Rama, jepe dorëheqjen

1 DITE ME PARE

Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

LIVE UPDATES

"Diaspora është me ne"/ Berisha: Rama është e shkuara, PD duhet të bëjë gjithçka për ripërtëritjen e saj

• Kryetari i Partisë Demokratike Sali Berisha foli për vizitën e tij në SHBA, zhvillimet politike në Shqipëri, çështjen e ish-drejtnesve të UÇK-së në Hagë, reformën territoriale dhe përgatitjet e opozitës për zgjedhjet lokale. • Gjatë bashkëbisedimit me qytetarët në rrjetet sociale, Berisha tha se gjatë vizitës në SHBA zhvilloi takime me kongresmenë, senatorë dhe zyrtarë të administratës amerikane, ku sipas tij ngriti shqetësimet e opozitës për trafikun e drogës, korrupsionin, zgjedhjet dhe drejtësinë në Shqipëri. • Duke iu referuar mesazhit të sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, Berisha theksoi se lufta kundër kartelevë të drogës dhe organizatave kriminale mbetet një çështje me rëndësi për SHBA-të. • Për zgjedhjet lokale, Berisha theksoi se opozita duhet të përshejtojë përgatitjet dhe tha se personalisht mbështet përdorimin e primareve për përzgjedhjen e kandidatëve, por me një proces seleksionimi paraprak. Berisha foli edhe për vendimet e Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-drejtnesve të UÇK-së. • Ai tha se krimet konkrete duhet të ndëshkohen, por shprehu rezerva për mënyrën se si është trajtuar përgjegjësia përmes linjave të komandimit. • Në lidhje me shëndetësinë, lideri demokrat, Sali Berisha kritikoi gjendjen e sistemit dhe koncesionet në këtë sektor, ndërsa deklaroi se Shqipëria ka profesionistë të aftë që mund të kontribuojnë në reformimin e shërbimit shëndetësor. • Berisha kundërshtoi bashkimin e bashkive dhe tha se PD do të ndjekë një politikë për ripopullimin e vendit. • Në përfundim të bashkëbisedimit, Berisha u bëri thirrje demokratëve dhe qytetarëve të mbështesin protestën rinore që po zhvillohet në Tiranë.

5 artikuj për këtë temë.

51 MINUTA ME PARE

"Është mik i ngushtë me kreun e SPAK"/ Berisha: Demo është i gatuar me bandat me të rrezikshme të vendit



Sali Berisha

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 12:14

EMRAT+DETAJE/ Burri vrau gruan në banesë, zbulohen identitetet, në shtëpi dhe nipi 14-vjeçar


Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka hedhur akuza ndaj Ministrit Ervin Demo, duke pretenduar se ai është i lidhur me disa prej grupeve kriminale më të rrezikshme në vend. Gjatë një bashkëbisedimi me qytetarët në rrjetet sociale, Berisha tha se Demo është vendosur në Ministrinë e Brendshme për shkak të lidhjeve të tij me krimin.

Berisha pretendoi se Demo është mik i ngushtë me kreun e SPAK-ut dhe se marrëdhënia e tij me strukturat kriminale është arsyeja përse ai i shërben interesave të Edi Ramës.

"Sadiku, në rast se ju kujtohet, në fjalën time në parlament ju drejtova këtij Lamallari, thashë se ky është Hiçollari. Ai u tërbua, në fakt ishte Hiçollari, po në një kuptim që atij s'i shkonte mendja. Në kuptimin e asaj që s'kishte asnjë peshë. E vuri figurant, se aty peshë ka vetëm po të jesh i lidhur me krimin. Të themi të vërtetën, ky nuk është se ishte një tip pozitiv të themi, jo s'ishte fare, por lidhje me krimin nuk di të kishte. Dhe siç u vu, iku hiçollar. Erdhi Demo, i gatuar me bandat më të rrezikshme të Shqipërisë. Prandaj erdhi aty. Nuk e di a e lexuat apo jo, kryetar bashkie, e shtruan në dru bandat, sipas qytetarit dixhital, sepse tenderin e rrugës nuk ia dha njërit prej atyre eksponentëve të krimit aty, po ia dha sekserit që në atë rast thuhej Baton Haxhia. Pra, çfarë u bë? U vu një i sojit të vet, të krimit, i lidhur me krimin dhe kështu i duhej Edi Ramës. Kaq është puna e tij. Ka dhe lidhje, ky është mik i ngushtë me kreun e SPAK-ut, se Edi Rama nuk është se nuk përjeton terror, se mendon se do t'i shkojnë ta arresojnë në zyrë. Mendon se do t'i shkojnë t'ia kontrollojnë zyrën. T'ia kontrollojnë shtëpinë. Sado që i ka në kontroll, prapë i ka frikë," tha Berisha./Dosja.al

1 ORE ME PARE


Berisha: Bajram Begaj ka plaçkitur prona dhe i ka ndarë me Ramën, atë e kap gjyqi ushtarak dhe mund të ketë dënime më të rënda



Sali Berisha

TIRANË- Kreu i Partisë Demokratike Sali Berisha ka akuzuar Bajram Begajn se vepron në interes të kryeministrit Edi Rama. Gjatë një bashkëbisedimi me qytetarët në rrjetet sociale, Berisha e cilësoi Begajn "kukull" të Ramës dhe pretendoi se Presidenti ka dosje të përbashkëta me kryeministrin për Gjirin e Sarandës, Limanin dhe zona të tjera ushtarake.

Kreu demokrat e akuzoi Begajn se ka marrë prona dhe i ka ndarë me Edi Ramën, duke e cilësuar bashkëautor në ato që ai i konsideron krime.



AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 12:06

Krim në familje/ Burri godet me thikë gruan, humb jetën në spital për shkak të plagëve

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 11:56

Çfarë ndodhi në Tiranë? Qëllohet me armë zjarri në ajër, plagoset lehtë një person

më të klikuarat

EKSKLUZIVE/ Erion Vellaj del nga qelia, kryebashkiaku shtrohet në spitalin Salus

Pagat e magistratëve/ Shefja e Thesarit Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...

Kuvendi miratoi formulën e re të pagave, magistratët nuk tërhiqen: Do e çojmë në Gjykatën Kushtetuese

Emri i një pensionisti u përdor për ndryshimin e 45 identiteteve. Pezullohen 2 zyrtarë, Indrit Aliu shpallet në kërkim

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Vellaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

"E ke shumë të drejtë. E keni shumë të drejtë. Sepse ky u vu aty si kukull. Ky është një delinkuent, i cili me dosjet që ka së bashku me Edi Ramën për Gjirin e Sarandës, për Limanin, për zonat e tjera ushtarake, ky mund të shkojë... se këtë e kap gjyqi ushtarak dhe mund të ketë dënimit më të rënda që ka kodi për to. Prandaj dhe ky është bashkëautor në krime. Po nga doli ky? Si doli ky mjek, shef i shtabit të përgjithshëm? Që ky e vetmja gjë që diti t'ua plaçkisë pronat dhe t'i ndajë me Edi Ramën," tha Berisha./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Berisha: Ministria e re e Shëndetësisë është thjesht një kukull në duart e zezë të Surrelit



Sali Berisha

TIRANË- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka komentuar ndryshimet e fundit në qeveri, duke u ndalur te ministria e re e Shëndetësisë, Klodiana Spahi. Për ministrin e Shëndetësisë, Berisha përdori një gjuhë të ashpër kritike, duke e lidhur emërimin e saj me kryeministrin Edi Rama.

Ai tha se nuk e njeh personalisht ministrin dhe se nuk mund ta paragjykojë për shkak të lidhjeve familjare, por vuri në pikëpyetje vendosjen e një ekonomiste në drejtimin e këtij dikasteri. Sipas Berishës, shëndetësia është aktualisht një gjendje shumë të rënduar dhe emërimi i ministres së re lidhet me atë që ai e cilësoi si "dorën e zezë të Surrelit".

"Shëndetësia është në gjendjen më të vajtueshme. Më të vajtueshme, më të mjerë, më të shpartalluar. Dhe unë do t'u them shqiptarëve sot një gjë. Në qoftë se do ekzistonte vullneti politik, ky vend sot mund të kishte një shëndetësi absolutisht krejt tjetër. Shumë herë më cilësore se kjo që kemi sot. Pse e them këtë? Sot ka personalitete botërore shqiptare në shëndetësi. Sot ka shqiptarë liderë botërorë në fusha të caktuara. Sot ka shqiptarë, të cilët për një apo disa arsye, për shkak të pensionimit apo të tjerë, në qoftë se ky vend i thërret në përputhje me kushtet që kërkojnë, sepse ai për të ardhur do kushtet për të reguar veten, mund t'u japë shqiptarëve shërbimet e cilësisë më të lartë. Ky është një realitet krejt tjetër.

Sot ka ekspertë në organizimin e shëndetësisë që dërgohen nga OBSH-ja për të organizuar shëndetësinë në vende të tjera. Ka kirurgë, ka kardiologë, ka radiologë. Kjo ministria që iku, kjo në fushën e saj, absolutisht nga më të mirat, në imazheri. Dhe në vend se t'i jepej fusha ku ajo ka kontribuar në Kembrixh, ka kontribuar në Nju Jork, ka kontribuar në Romë, ajo u emërua ministre se e donte Edi Rama për ta përdorur për të vjedhur. Pra, sot ka një oportunitet. Si u vu kjo? U vu për të marrë tezakën e Surrelit. Për kaq u vu ajo. U vu në mënyrë që dora e zezë e Surrelit të shtrihet...

Tani a mund të imagjinoi ju? Një ekonomiste, unë nuk e njoh fare, nuk mund ta paragjykojë pse është kushërira e z. kryeministrit, po problemi është se si mund të vësh një ekonomiste në krye? Po pse nuk kishte dikush tjetër? Çfarë ka ajo që mund ta bëjë të jetë e vetmja që të zgjidhet? Përveç dorës së zezës së Surrelit, asgjë. Ajo tjetra nuk e bëri. Ajo e pa që ky po krijonte KAYO-n e dytë në shëndetësi. Jo, tha, nuk e firmosi. Tregoi një karakter, të themi të vërtetën. Kështu që, shëndetësinë e mori në dorë Edi Rama tani, nuk ka më, ajo është kot fare, është një kukull në duart e Surrelit," tha Berisha./Dosja.al

2 ORE ME PARE

Vendimet e Gjykatës Speciale/ Berisha: Asgjë nuk e nxin luftën Çlirimtare të Kosovës, duhet një ekip i fuqishëm dhe kompetent për të bërë

apelimin



Sali Berisha

TIRANË- Kryedemokrati Sali Berisha ka reaguar lidhur me vendimet e fundit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj ish-drejtesve të UÇK-së, duke i cilësuar dënimet si një zhvillim të rëndësishëm për shqiptarët. Në një bashkëbisedim, Berisha tha se askush nuk duhet të kundërshtojë ndëshkimin e autorëve të krimeve konkrete, por ngriti pikëpyetje mbi mënyrën se si është argumentuar përgjegjësia e ish-drejtesve të UÇK-së.

Sipas Berishës, nga përmbledhja e vendimit të lexuar nga gjyqtari Charles Smith krijohet përshtypja se dënimet janë mbështetur në ekzistencën e linjave të komandimit. Berisha argumentoi se UÇK-ja ishte një lëvizje guerile dhe jo një ushtri e rregullt, ndërsa theksoi distancën që, sipas tij, ekzistonte mes drejtesve politikë në Tiranë dhe zhvillimeve në terren.

"Natyrisht, java që lamë pas nuk ishte një javë e mirë për shqiptarët. Ish-udhëheqja politike e UÇK dhe Kosovës mori nga Gjykata e Dhomave të Specializuara verdikte ndër më të rëndat. Duhet të sqarohemi, asnjëri dhe askush nuk mund të jetë kundër dënimit të krimeve konkrete, vrasjeve konkrete, akteve të tjera. Dhe, në këtë kuadër, në çdo rrethanë drejtësia duhet të japë fjalën e saj. Por në këtë rast, duhet të jemi të hapur, nga ai lexim i vendimit të shkurtuar nga gjykatësi Çarls Smith, krijohet përshtypja se të akuzuarit u dënuan për linja komandimi dhe kjo natyrisht është absolutisht e paqëndrueshme në rast se ajo nuk është e faktuar me dokumente. Sepse është shumë e njohur, vërtet UÇK ishte një lëvizje e fuqishme guerile, por ajo nuk ishte një ushtri e rregullt siç e paraqiti në vendimin e tij. Përfaqësuesit e saj në Tiranë, z. Thaçi, z. Krasniqi kanë qenë pa dyshim figurat kryesore, por distanca me terrenin ishte shumë e madhe.

Ndaj, përveç kësaj, shqiptarët e kanë shumë të vështirë të imagjinojnë që arkitektët e Operacionit famëzi Patkoi, operacionit të spastrimit masiv etnik dhe të gjenocidit në Kosovë, të marrin dënime shumë më të lehta se sa çlirimtarët e Kosovës. Pra, edhe nëherë, ne kemi mbështetur dhe mbështesim ndëshkimin e autorëve konkretë dhe të krimeve konkrete. Por linjat e komandës dhe dënimi me linja komande nuk ka një bazë solide dhe mendoj se në këtë kuadër, problem shumë serioz përbën kuadri ligjor mbi të cilin ka vendosur ligjvënësi gjykatën. Meqë jemi tek gjykata, jashtë emocioneve, ngritja e Gjykatës së Kosovës, çdo shqiptar në Kosovë duhet ta dijë se ngritja e saj në Hagë është bërë për shkak të një detyrimi. Në qoftë se Serbia e ngriti në Beograd, Kroacia në Zagreb, kjo gjykatë e Kosovës u ngrit në Hagë për një motiv, për shkak të vrasjes së dëshmitarëve. Kjo është e vërteta. Dhe gjykata nuk mund të mos ngrihet.

Gjykata u ngrit edhe për një arsye të dytë, në mënyrë që tribunali për ish-Jugosllavinë të mos aplikojë më tutje në rastin e Kosovës. Pra, nuk është një akt i precedent, secili nga vendet... por problemi është se Kosova ishte e pushtuar, Kosova ishte viktimë e një agresioni barbar, e një pushtimi barbar. Nuk mund të akuzosh tjetrin se ka ngritur institucionin e zbulimit. Të akuzosh se ka marrë në pyetje. Po cila ushtri në luftë, cila lëvizje guerile në luftë nuk merr në pyetje? Pra, shumë elementë që dëgjuam nga vendimi i shkurtuar, vendimin e gjatë nuk e kam parë, ishin larg në vlerësimin tonë justifikimit të atyre dënimeve që dëgjuam. Duke shprehur këtë, shoh një diskutim intensiv për këtë problem tashmë që ka vetëm përgjigje juridike. Ky problem ka apelimin si rrugë të vetme.

Të gjitha përpjekjet e tjera, i garantoj qytetarët veçse sa ndërlikojnë tashmë jo vetëm ish-udhëheqësit politikë të Kosovës, por edhe vetë Kosovën. Ndaj dhe ajo që unë mendoj është e domosdoshme, një ekip mbrojtje sa më kompetent dhe i fuqishëm, ndonëse unë nuk kam asnjë fakt aktual të them se mbrojtja aktuale nuk ishte e fuqishme, por pasi të shqyrtohet vendimi përfundimtar i plotë, unë mendoj se apeli që duhet të ndiqet pa humbur kohë pasi vetë gjykata ka përcaktuar afate. E përfundoj këtë, asgjë nuk mund të errësojë, nuk mund të zvogëlojë lavdinë e luftëtarëve të lirisë, e luftës çlirimtare të Kosovës, e cila është pa dyshim faja më e ndritur e luftërave shqiptare për liri dhe dinjitet që nga koha e Skënderbeut. Ajo luftë, në kombinim të plotë me ofensivën ajrore të NATO-s, të udhëhequr nga presidenti Bill Clinton, çliroi Kosovën nga pushtimi serb dhe në atë rrugë e sipër ajo u bë e pavarur. Ndaj dhe nuk duhet askush të mendojë se lufta çlirimtare e luftëtarëve të lirisë mund të nxihet ose mund të damkoset. Aspak. Aspak," tha Berisha./Dësja.al

2 ORE ME PARE

Berisha zbulon angazhimin e diasporës: Janë të

gatshëm për të mbështetur përpjekjet e opozitës për të çmontuar këtë regjim



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.